

**LEGAL CERT shpk** është e ndergjegjeshme që veprimtaria e çertifikimit bazohet mbi parimin e transparences, profesionalizmit dhe paanshmerise se organizmit të çertifikimit, mbi integritetin e personelit të angazhuar në proceset e vleresimit, dhe mbi të gjitha mbi pavaresine, paanshmerine dhe mungesën e konfliktit të interesave e veprimtarise se tij kundrejt klientit dhe subjekteve të përfshira, në mënyrë të drejtperdrejte ose indirekte, në ushtrimin korrekt të veprimtarise se organizmit.

**LEGAL CERT shpk** kryen aktivitetet e vleresimit të konformitetit në mënyrë të paanshme dhe duke garantuar: **1.** kërkesën e paanshmerise se aktiviteteve të saj të vleresimit të konformitetit; **2.** Mungesa e presioneve të natyrës tregtare, financiare etj.

**LEGAL CERT shpk** ka krijuar qarte në politikat e saj angazhimin për paanshmeri gjatë të gjithë procesit të çertifikimit dhe angazhohet gjithashtu të garantojë administrimin korrekt të:

**Konflikteve të brendshme të interesit, të personelit të brendshëm dhe/ose të jashtëm nepermjet:**

- Kryerjes së një analize vleresimi të kercenimeve ndaj paanshmerise;
- Hartimit të deklaratave për ruajtjen e konfidencialitetit dhe shmangien e konflikteve të interesit të cilat do t'i nënshtrohen nënshkrimit nga të gjitha subjektet e përfshira në veprimtarine e organizmit;
- Ngritjes së një Komiteti për Ruajtjen e Paanshmerise i cili do të garantojë shmangien e sjelljeve diskriminuese;

**Objektivitetit në të gjitha veprimtarite nepermjet:**

- Rekrutimit të auditoreve dhe eksperteve teknike të kualifikuar dhe që zoterojnë kompetencat e nevojshme për kryerjen e veprimtarise se vleresimit pranë klienteve;
- Rekrutimit të personelit të brendshëm të kualifikuar për kryerjen e veprimtarive në mënyrë që të garantojnë njohuri të gjera procedurale dhe teknike;
- Ngritjes së një organi teknik dhe vendimmarres, në të cilin të përfshihen kapacitete teknike me qëllim marrjen e vendimeve lidhur me çertifikimet, me detyrat dhe kompetencat e përcaktuara në Rregulloren për Çertifikim të cilat garantojnë profesionalizmin e këtyre kapaciteteve;

**Sjelljes së paanshme nepermjet:**

- Hartimit të një liste tarifash, e cila i nënshtrohet miratimit të Komitetit për Ruajtjen e Paanshmerise, ku pasqyrohen kriteret për hartimin e ofertave të referuara në Udhezuesit IAF të zbatueshëm, krieteret për zbatimin e zbritjeve të mundshme etj;
- Administrimit korrekt të ankesave dhe apelineve nepermjet një komisioni të posaçëm pale e trete e pavarur nga **LEGAL CERT shpk**;
- Zbatimit të parimit të konfidencialitetit lidhur me informacionet e marra mbi subjektet kliente;
- Zbatimin e Kodit të Etikës dhe sjelljes.

**Date: Tetor, 2021**

**Drejtoria e Përgjithshme**

